



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 93 Prot

Tiranë, më 04, 06, 2012

VENDIM Nr. 200, dt. 04.06.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 04.06.2012, pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i HEC-eve Gojan, Peshqesh dhe Ura e Fanit në Rrethet Mirditë dhe Pukë, mbi bazën e kërkesës së Subjektit "AYEN AS ENERGJI" sh.a., Durrës,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i HEC-eve Gojan, Peshqesh dhe Ura e Fanit në Rrethet Mirditë dhe Pukë, paraqitur nga Subjekti "AYEN AS ENERGJI" sh.a., Durrës.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, përkatësisht nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Tiranë dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Shkodër bazuar në kontratën dypalëshe midis "AYEN AS ENERGJI" sh.a. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("AYEN AS ENERGJI" sh.a.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Tiranë ose Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Shkodër në varësi të vendndodhjes së gjurmëve/objekteve të zbuluara.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E
SHËRBIMIT
ARKEOLOGJIK